



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

VENDIM

"Per mosfillimin e procedimit penal"

Ne Tirane sot me date 03.07.2018, Une Ardian Braho me detyre Prokuror ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane pasi u njoha me aktet e kallezimit penal nr.7471 te vitit 2018:

KONSTATOVA

Se me date 08.06.2018, shtetasi Ndue Pjetermarku, ne cilesine e avokatit mbrojtes si dhe ne cilesine e perfaqesuesit te shoqates "Shqiperia pa korrupsion pro vetting", ka depozituar nje kallezim penal, material i regjistruar me numer nr.7471, date 11.06.2018.

Sipas kallezuesit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka kryer procesin e rivleresimit kalimtar per shtetasen Besa Nikehasani, me funksion prokuror, me emerim ne Prokurorise prane Gjykates se Apelit, Shkoder dhe e komanduar ne Prokurorine e Apelit prane Gjykates se Apelit per Krime te Renda, Tirane.

Sipas kallezuesit, prokurore Besa Nikehasani, duke qene kandidat per anetare e Keshillit te Larte te Prokurorise, ne baze te nenit 279 te ligjit nr.115/2016 "Per organet e qeverisjes se sistemit te drejtesise", u eshte nenshtuar procedurave te rivleresimit me perparesi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur me date 30.11.2017, ne perputhje me "Rregulloren per procedurat e zhvillimit te shortit", nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Sipas kallezuesit, me vendim nr.30 akti, date 20.04.2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin nga detyra te subjektit te rivleresimit, shtetates Besa Nikehasani, prokurore prane Prokurorise se Apelit Shkoder.

Sipas kallezuesit, ne vendimin e tij, te shkarkuar nga faqja zyrtare ne sherbimin internet, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka konstatuar se prokurore Besa Nikehasani nuk plotesonte kriterin e pasurise per t'u kualifikuar dhe vijuar me tej ushtrimin e detyres. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka arritur ne konkluzionin se subjekti i rivleresimit, shtetaseja Besa Rexhep Nikehasani, rezulton se ka kryer deklarim te pamjaftueshem per kontrollin e pasurise, sepse deklarimi nuk eshte i sakte dhe ne perputhje me ligjin; subjekti ne menyre te perseritur pranon te kete gabime dhe pasaktesi ne deklarime, duke i konsideruar ato lapsuse; nuk ka burime financiare te ligjshme per te justifikuar pasurite; ka mungese te burimeve

2

financiare te ligjshme per pasurite qe ka ne pronesi, mungese te dokumentacionit ligjor per pronesine e ketyre burimeve te pretenduara; ka kryer fshehje te pasurise ne shuma te vogla; ka kryer deklarim te rreme ne menyre te perseritur, duke u perpjekur te justifikoje veprimet e viteve te meparshme me deklarata noteriale te sapohartuara.

Sipas deklaruesit, ne baze te konkluzioneve te Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, subjekti i rivleresimit, shtetaseja Besa Nikehasani ka konsumuar elementet e vepres penale te parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dyte i Kodit Penal, dhe pikerisht te vepres penale te "Refuzimi per deklarimin ose mosdeklarimi i pasurise se personave te zgjedhur ose nepunesve publike sipas ligjit, kur me pare jane marre masa administrative, perben kundervajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim deri ne 6 muaj. Fshehja ose deklarimi i rreme i pasurive te personave te zgjedhur dhe nepunesve publike denohet me gjobe ose me burgim deri ne tre vjet".

Sipas kallezuesit, shprehja e perdorur nga Komisioni ne konkluzionin e tij se prokurore Besa Nikehasani ka perdorur deklarata noteriale te sapohartuara, perben nje falsifikim te rende te kryer gjate detyres nga ana e prokurores.

Sipas kallezuesit, ka paraqitur kallezimin e mesiperm pasi nga te dhenat e bera publike deri me tani, nuk rezulton qe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit te kete dorezuar kallezim per ndjekje penale ndaj subjektit Besa Nikehasani, pavaresisht konstatimeve te tij dhe Institucioni i Prokurorise nuk ka nisur me inisiative te tij asnje hetim penal ndaj shtetases Besa Nikehasani, pavaresisht se konstatimet e Komisioni i Pavarur i Kualifikimit jane publike dhe sherbejne si nje baze e rendesishme per regjistrimin e procedimit penal dhe per kryeijen e hetimeve te plota lidhur me pasurine e shtetases Besa Nikehasani.

Sipas kallezuesit, prokurore Besa Nikehasani, e emeruar ne Prokurorine prane Gjykates se Apelit, Shkoder, eshte komanduar para pak muajsh si prokurore ne Prokurorine prane Gjykates se Apelit per Krime te Renda, me firmen e Prokurores se Pergjithshme te Perkohshme, Arta Marku, ne zbatim te paqarte te kompetencave ligjore, si edhe ne kundersiztim me deklarimet publike, dhene para Komisionit per ceshtje Ligjore ne Kuvendin e Shqiperise, ku deklaroi se "nuk do to kete me komandime te prokuroreve".

Sipas kallezuesit, duket qarte se prokurore Besa Nikehasani perfshihet ne listen e personave te preferuar te Prokurores se Pergjithshme te Perkohshme, per aq sa kjo e fundit ka ndermarre veprime qe nuk gjejne mbeshtetje ne ligj dhe ndoshta sipas kallezuesit, kjo eshte arsyeja qe Prokurori i Pergjithshem i Perkohshem nuk ka ndermarre asnje veprim ligjor per nisjen e procedimit penal per shtetasen Besa Nikehasani, pavaresisht konstatimeve Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Ne analize te dhenave te kallezimit, arrijme ne konkluzionin se ne lidhje me faktet e kallezuara jemi ne kushtet kur organi i prokurorise nuk mund te ushtroje ndjekje penale.

3

Sic parashtruan me lart, faktet e pretenduara ne kallezim, sikunder pasqyron edhe ne kallezimin e tij shtetasi Ndue Pjetermarku, perbejne fakte te cilat kane rezultuar gjate procesit te rivleresimit kalimtar per shtetasen Besa Nikehasani, me funksion prokuror, me emerim ne Prokurorise prane Gjykates se Apelit, Shkoder dhe e komanduuar ne Prokurorine e Apelit prane Gjykates se Apelit per Krime te Renda, Tirane. Faktet e pretenduara ne kallezim nuk jane fakte te konstatuara jashte procesit te rivleresimit, ku per rrjedhoje edhe analiza jone do te shtrihet mbi konstatimet e Komisionit te Pavarur te Kualifikimit, kompetencave te Komisionit te Pavarur te Kualifikimit dhe te Kolegjit te Apelimit, gjendjes faktike dhe juridike te subjektit te rivleresimit ne raport me dy institucionet e mesiperme si dhe ushtrimi i ndjekjes penale nga organi i Prokurorise ne raport me gjetjet e ketyre insitucioneve.

Ne ligjin nr.84/2016 "Per rivleresimin kalimtar te gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republiken e Shqiperise" parashikohet si me poshte:

Ne nenin 1 te ligjit, qe ka te beje me qellimin e ligjit, parashikohet se qellimi i ligjit eshte percaktimi i rregullave te posaçme per rivleresimin kalimtar te te gjithë subjekteve te rivleresimit per te garantuar funksionimin e shtetit te se drejtes, pavaresise se sistemit te drejtesise, si dhe rikthimin e besimit te publikut tek institucionet e ketij sistemi, sipas parashikimeve te nenit 179/b te Kushtetutes.

Ne nenin 4 te ligjit, qe ka te beje me objektin dhe parimet e procesit te rivleresimit, parashikohet qe procesi i rivleresimit kryhet mbi bazen e tre kritereve, vleresimi i pasurise, kontrolli i figures dhe vleresimi i aftesive profesionale. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Apelimit jane institucionet qe vendosin per vleresimin perfundimtar te subjekteve te rivleresimit. Vendimi merret bazuar ne nje ose disa prej kritereve, ne vleresimin e pergjithshem te tre kritereve, ose ne vleresimin teresor te procedurave. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit ushtrojne funksionet e tyre si institucione te pavarura dhe te paanshme, mbi bazen e parimeve te barazise perpara ligjit, te kushtetutshmerise e ligjshmerise, te proporcionalitetit dhe te parimeve te tjera qe garantojne te drejten e subjekteve te rivleresimit per nje proces te rregullt ligjor.

Ne nenin 5 te ligjit, qe ka te beje me institucionet e rivleresimit, parashikohet qe procesi i vleresimit te subjekteve te rivleresimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, komisioneret publike, ne bashkepunim me vezhguesit nderkombetare.

Ne nenin 30 te ligjit, qe ka te beje me objekti i vleresimit te pasurise, parashikohet qe objekti i vleresimit te pasurise eshte deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmerise se burimit te krijimit te tyre, i permbushjes se detyrimeve financiare, perfshire interesat private per subjektin e rivleresimit dhe per personat e lidhur te tij.

Ne nenin 33 te ligjit, qe ka te beje me proceduren e vleresimit te pasurise, parashikohet qe Inspektoriati i Larte i Deklarimit dhe

4

Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollit të Konfliktit të Interesave, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me këtë ligj, ligjin "Për deklaratimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nepunesve të caktuar publikë", ligjin "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundimin të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollit të Konfliktit të Interesave përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, konstaton se deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti i interesit; ka mundësi të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; është kryer fshehtë e pasurisë; është kryer deklarim i rreme dhe subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Në nenin 62 të ligjit, që ka të bëjë me të drejtat e subjektit të rivleresimit pas dënies së vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, parashikohet që subjekti i rivleresimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masën disiplinore të drejtën e ankimit nga detyra, pezullohet, ex lege, nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelimeve. Gjate periudhës së pezullimit atij i njihet e drejta e pages në masën 75 për qind të saj, në përputhje me nenin F, pikë 5, të Aneksit të Kushtetutës. Në këtë rast, subjekti i rivleresimit nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje. Ai është i detyruar të ofrojë një adresë elektronike alternative për vazhdimin e komunikimit me institucionet e rivleresimit, gjatë gjithë procesit.

Në nenin 63 të ligjit, që ka të bëjë me paraqitjen e ankimit, parashikohet që të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivleresimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit që ka dhënë vendimin, sipas nenit 46 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative".

Në nenin 66 të ligjit, që ka të bëjë me Vendimin e Kolegjit të Apelimit, parashikohet që pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji i Apelimit vendos lenien në fuqi të vendimit të Komisionit; ndryshimin e vendimit të Komisionit; prishjen e vendimit të Komisionit. Kolegji i Apelimit, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme. Vendimi i Kolegjit të Apelimit, që vendos shkarkimin nga detyra, ka efekt të menjehershëm ex lege.

Nga të dhënat e kallezimit si dhe nga materiali shkresor bashkelidhur kallezimit, rezultoi se me vendimin nr.30 akti, datë 20.04.2018, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivleresimit, shtetates Besa Nikehasani, prokuror pranë Prokurorisë së Apelit, Shkoder.

Nga të dhënat e kallezimit si dhe nga materiali shkresor bashkelidhur kallezimit rezultoi që shkarkimi i shtetases Besa

Nikehasani nga funksioni i prokurorit ka pasur si shkak njerin prej kritereve, vleresimin e pasurise.

Nga te dhenat e kallezimit rezultoi se nisur nga konstatimet e mesiperme te Komisionit te Pavarur te Kualifikimit ne lidhje me vleresimin e pasurise, kallezuesi ka gjykuar se shtetaseja Besa Nikehasani ka konsumuar elementet e vepres penale te parashikuara nga neni nga neni 257/a paragrafi i dyte i Kodit Penal.

Sikunder parashtruam me lart, ne nenet 30 dhe 33 te ligjit nr.84/2016 "Per rivleresimin kalimtar te gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republiken e Shqiperise", objekti i vleresimit te pasurise eshte deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmerise se burimit te krijimit te tyre, i permbushjes se detyrimeve financiare, perfshire interesat private per subjektin e rivleresimit dhe per personat e lidhur te tij. Inspektoriati i Larte i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Kontrollit te Konfliktit te Interesave, bazuar ne deklarimet e pasurive, zhvillon nje procedure te plote kontrolli ne perputhje me aktet ligjore te pasqyruara ne ligjin e sipercituar. Nga te dhenat e kallezimit, nga studimi i vendimit nr.30 akti, date 20.04.2018, te Komisionit te Pavarur te Kualifikimit, ne faqen tre te ketij vendimi, pasqyrohet fakti qe ne perfundim te kontrollit te pasurise, Inspektoriati i Larte i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Kontrollit te Konfliktit te Interesave ka depozituar nje raport te plote duke konstatuar se nga veprimet verifikuese per subjektin ne fjale ka rezultuar se deklarimi eshte i sakte dhe ne perputhje me ligjin; ka burime financiare te ligjshme per te justifikuar pasurite; nuk ka kryer fshehje te pasurise; nuk ka kryer deklarim te rreme si dhe nuk gjendet ne situaten e konfliktit te interesit.

Pavaresisht konstatimit te mesiperme, sikunder parashikohet edhe ne ligjin e sipercituar, eshte e drejta e Komisionit te Pavarur te Kualifikimit te realizoje nje hetim administrativ me te thelluar ne drejtim te ligjshmerise se burimit dhe krijimit te pasurive te subjektit. Ne perfundim te procesit, te hetimit administrativ, mund te rezultoje ne nje konkluzion te kundert me raportin e Inspektoriatit te Larte te Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Kontrollit te Konfliktit te Interesave, sikunder edhe ka ndodhur ne rastin e shtetases Besa Nikehasani ne lidhje me objektin e vleresimit te pasurise.

Sikunder parashtruam me lart, ne nenin 62 te ligjit te sipercituar, subjekti i rivleresimit pas dhenies se vendimit te Komisionit te Pavarur te Kualifikimit, i cili ka ushtruar te drejten e ankimit ndaj vendimit te Komisionit per masen disiplinore per shkarkimin nga detyra, pezullohet, ex lege, nga detyra e tij ne pritje te vendimit te Kolegjit te Apelimeve, ku atij i njihet e drejta e pages ne masen 75 per qind te saj, por nuk ka te drejte te shqyrtoje dhe te gjykoje ceshtje. Kolegji i Apelimit vendos lenien ne fuqi te vendimit te Komisionit; ndryshimin e vendimit te Komisionit; prishjen e vendimit te Komisionit. Kolegji i Apelimit, ne arsyetimin e vendimit te tij, orienton Komisionin per zgjidhjen e ceshtjeve te ngjashme. Vendimi i Kolegjit te Apelimit, qe vendos shkarkimin nga detyra, ka efekt te menjehershem ex lege.

Ne interpretim te dipsozitive ligjore te mesiperme rezulton se subjekti i ligjit te sipercituar qe shkarkohet faktikisht nga detyra me vendimin e Komisionit te Pavarur te Kualifikimit, pezullohet dhe nuk

mund te ushtroje funksionin e prokurorit apo te gjyqtarit, por ai vazhdon te jete juridikisht ne funksionin e prokurorit apo gjyqtarit, derisa Kolegji i Apelimt te kete vendosur per nje gje te tille. Per rrjedhoje edhe shkaku per te cilin eshte shkarkuar subjekti i ligjit nuk ka vlere juridike deri ne momentin e vendimit te Kolegjit te Apelimt, fakt i cili ne rastin konkret objekt kallezimi gjykojme qe ka qene shkak edhe per mosushtrimin e kallezimit ndaj subjektit, shtetases Besa Nikehasani, nga Komisioni i Pavarur te Kualifikimit, sikunder pohohet edhe nga kallezuesi.

Ne perfundim, gjykojme se perderisa Kolegji i Apelimt, ne cilesine e organit shteteror kompetent sipas ligjit, nuk eshte shprehur akoma ne lidhje me vendimin nr.30 akti, date 20.04.2018 te Komisionit te Pavarur te Kualifikimit, faktet e kallezuara, te mbeshtetura pikerisht mbi arsyetimin dhe konkluzionet e ketij vendimi, nuk perbejne objekt te ushtrimit te ndjekjes penale nga organi i Prokurorise.

Per sa me siper duke konsideruar se per faktet e kallezuara nuk mund te ushtrohet ndjekje penale, ne mbeshtetje te neneve 290 pika 1, germa "e" dhe 291 te K.Pr.Penale:

V E N D O S A

1. Mosfillimin e hetimeve ne lidhje me kallezimin penal nr.7471 te vitit 2018 per shkaku e sipershkruar ne pjesen arsyetuese te vendimit.

2. Njohjen me kete vendim te kallezuesit, i cili ka te drejten e ankimit ne Gjykatën e Shkalles se Pare, Tirane brenda 10 (dhjete) diteve nga njoftimi i vendimit.

PROKURORI

Ardian BRAHO

